



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatësi Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 17 dhjetor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

**Vendimi i dytë për ndryshimin e orarit të paraqitjeve të para të z. Gucati dhe z. Haradinajt**

---

**Prokurorit të Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit të Hysni Gucatit**  
Xhonathan Elistan Ris  
Hju Bouden

**Mbrojtësit të Nasim Haradinajt**  
Bastiaan Martens

**GJYKATËSI i PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> sipas nenit 39(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullave 87(6) dhe 92(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave përpara Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), jep këtë vendim.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 14 dhjetor 2020, pas konfirmimit të Aktakuzës kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt (“përkatësisht, z. Gucati” dhe “Z. Haradinaj” dhe së bashku, “të akuzuarit”),<sup>2</sup> Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi një vendim i cili, ndër të tjera, caktonte datën për paraqitjet e tyre të para.<sup>3</sup>

2. Më 15 dhjetor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi një datë të re për paraqitjen e parë të z. Haradinaj,<sup>4</sup> sipas një kërkesë nga mbrojtësi i tij.<sup>5</sup>

3. Më 16 dhjetor 2020, Mbrojtja e z. Gucati paraqiti një kërkesë me anë të së cilës kërkonte shtyrjen e paraqitjes së parë të z. Gucati nga ora 11:00 në orën 14:00 të premtën, 18 dhjetor 2020 (“Kërkesa e Gucati”). Mbrojtja e z. Gucati vuri në dukje se shtyrja u kërkua për të pakësuar kohën e udhëtimit dhe të qëndrimit në transit.<sup>6</sup> Mbrojtja e z. Gucati gjithashtu tregoi se Mbrojtja e z. Haradinaj ishte pajtuar me të për ta afruar paraqitjen e z. Haradinaj nga ora 14:00 në orën 11:00 të premtën, 18

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetari, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 29 tetor 2020, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00074, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për konfirmimin e Aktakuzës*, 11 dhjetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Aktakuza e konfirmuar e akuzon z. Gucati dhe z. Haradinaj për vepra penale sipas neneve 387, 388, 392 dhe 401 të Kodit Penal të Kosovës, Ligjit nr. 06/L-074, në bazë të nenit 15(2) të Ligjit. F00075/A02, Prokurori i Specializuar, Aktakuza e redaktuar, 14 dhjetor 2020, publike.

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00076, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim i caktimit të datës për paraqitjen e parë dhe çështje të lidhura me të*, 14 dhjetor 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00078, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim për ndryshimin e datës së paraqitjes së parë të z. Haradinaj*, 15 dhjetor 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00077, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Kërkesë urgjente për shtyrjen e paraqitjes së parë në 18 dhjetor 2020*, 14 dhjetor 2020 (parashtruar më 15 dhjetor 2020), publik, para. 4 (f. 2-3).

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, F00079, Mbrojtja e z. Gucati, *Kërkesë për shtyrjen e orës së caktuar për seancën e paraqitjes së parë (“Kërkesa e Gucati”)*, 16 dhjetor 2020 (parashtrimi mban datën e gabuar 15 dhjetor 2020), konfidenciale, para. 4.

dhjetor 2020.<sup>7</sup> Gjithashtu, Mbrojtja e z. Gucati kërkoi që z. Gucati të sillej në mjediset e Dhomave të Specializuara dy orë përpara paraqitjes së parë, me qëllim që mbrojtësi dhe bashkëmbrojtësi i tij të mund të takohen me të.<sup>8</sup>

4. Më 17 dhjetor 2020, Mbrojtja e z. Haradinaj parashtroi një njoftim ku tregonte se pajtohej me kërkesën e *Gucatit*.<sup>9</sup>

## II. VENDIM

5. Mbi bazën e arsyeve të lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **VENDOS** të ndryshojë orarin e paraqitjes së parë të z. Haradinaj të **premtën, 18 dhjetor 2020, në orën 11:00;**
- b) **VENDOS** të ndryshojë orarin e paraqitjes së parë të z. Gucati të **premtën, 18 dhjetor 2020, në orën 14:00;**
- c) **FTON** Mbrojtjen e z. Gucati të lidhet me njësitë kompetente të Zyrës Administrative për të kërkuar marrjen e masave të nevojshme për transferimin e z. Gucati në mjediset e Gjykatës dy orë përpara seancës; dhe
- d) **U KUJTON** Mbrojtjeve të të dy të akuzuarve dispozitat e zbatueshme sipas rregullës 82(4) të Rregullores lidhur me klasifikimin e parashtrimeve dhe **I URDHËRON** ata të parashtrojnë deri të **premtën, 18 dhjetor 2020, ora 16:00,** versionet e redaktuara publike të kërkesave të tyre (F00079, F00080), ose të tregojnë gjatë paraqitjes së tyre të para nëse kërkojnë riklasifikimin e tyre si publike.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatësi Nikola Giju**

**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

---

<sup>7</sup> *Kërkesa e Gucatit*, para. 5.

<sup>8</sup> *Kërkesa e Gucatit*, para. 6.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, F00080, Mbrojtja e z. Haradinaj, *Pëlqimi për ndryshimin e orarit të seancës së 18 dhjetorit 2020*, konfidenciale, para. 3.

E enjte, 17 dhjetor 2020  
Hagë, Holandë.